



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr 235/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej z. Agon Ramadani- Kryetar, znj. Kimete Gashi- Anëtare si dhe z. Vedat Poterqoi- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “MONUNI” SHPK sh.p.k - Gjilan, kundër njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit: “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me nr. prok 616-22-5704-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK Prishtinë, më datën: 17. 08. 2022, mori këtë:

V E N D I M

- I.** Hudhet si e palejuar, ankesa e operatorit ekonomik: “MONUNI” SHPK sh.p.k - Gjilan, kundër njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit: “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”, me nr. prok 616-22-5704-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK Prishtinë.
- II.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- III.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.
- IV.** Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 109 dhe 108/A paragrafi 2 të LPP-së, operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.

- V. Obligohet, Operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6-të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Autoriteti kontraktues ka publikuar me datën 13 qershor 2022 njoftimin për kontratë. Afati i fundit për dorëzim të ofertave ka qenë me datën 01. 08. 2022, kriter për dhënie çmimi më i ulët, procedurë e hapur, vlerë e madhe.

Operatori ekonomik ankues "MONUNI" SHPK sh.p.k -Gjilan si palë e pakënaqur më datën: 28. 06. 2022, ka parashtruar ankesë me numër 235/22, kundër vendimit për kontratë: "Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor", me nr. prok 616-22-5704-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK Prishtinë.

Paneli shqyrtues me rastin e tërheqjes për vendosje të lëndës, gjatë mbajtjes së seancës për këshillim-votim me datë 16.08.2022, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit teknik të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedure, ka konstatuar se ankesa e dorëzuar nga Operatori Ekonomik Ankues është e palejuar dhe nuk do të ishte dashur që të pranohej fare për shqyrtim nga OSHP, sipas nenit 109, paragrafi 2 si dhe në nenin 108/A, paragrafi 6, të LPP-së.

Paneli shqyrtues ka konkluduar se me këtë rast nuk janë respektuar afatet kohore për parashtrim të ankesave konform legjislacionit në fuqi. Duke u nisur nga fakti se dispozitat ligjore të LPP-së konkretisht neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve paragrafi 3 dhe nën paragrafi 6 përcakton se:

6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Ndërsa, paragrafi 2 i Nenit 109 përcakton:

2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Afatet kohore janë të rregulluara me dispozitat ligjore nga neni 5.1 të Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 ku saktësisht përcaktohet se kur fillon kalkulimin e afateve:

5. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00.

Me çka përcaktohet fillimi i afatit, që nënkupton fillon në ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune.

Lidhur me rastin konkret, vlen të sqarohet që:

Operatori ekonomik kërkesën për rishqyrtim e ka bërë me datë 24.06.2022 lidhur me këtë aktivitet prokurimi, ky informacion është marrë nga vendimi për refuzim të kësaj kërkesë, për vetë faktin se kjo kërkesë nuk gjendet askund tek portali e-prokurimi dhe nuk është prezantuar nga palët asnjëherë gjatë procedurave të shqyrtimit.

Kalkulimi i afateve për shqyrtimin e kësaj kërkesë duke u bazuar në dispozitat e lartcekura qëndron si në vijim:

Kërkesa për rishqyrtim është bërë me datë 24.06.2022 (ditë e Premte), nëse llogariten 3 ditë pune del që kjo ka kërkesë ka pasur afat shqyrtimi 3 ditë, që përlllogaritet si në vijim: 27.06 (e Hënë), 28.06 (e Martë) si dhe 29.06 (e Mërkurë), ky afat përveç të tjerash mund edhe të zgjatet në raste specifike, nëse nuk zgjatet, në rastin tonë i bie që vendimin e Autoritetit Kontraktues për kërkesën për rishqyrtim është dashur që të pritët nga Operatori Ankues të paktën deri me datë 29.06, ora 16:00.

Ndërsa OE ankues Monuni shpk, ka parashtruar ankesën në OSHP me datë **27.06.2022**, e cila është protokolluar me datë **28.06.2022**, **duke mos pritur** vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues, i cili është publikuar në portalin e-prokurimi me datë **30.06.2022**, që do të thotë që Ankesa në OSHP është parashtruar para Vendimit për kërkesën për rishqyrtim.

Bazuar në faktet e mësipërme, Paneli Shqyrtues konsideron se në këtë rast nuk janë respektuar afatet kohore të rregulluara me ligj, andaj kjo ankesë hedhet poshtë si e palejuar.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

**Kryetar i PSH-së
Agon Ramadani**



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK Prishtinë

1x1 OE "Monuni"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.